



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA MITROVICA NORTH MUNICIPALITY	
Njesia Org. Org. Jeshme Org. Unit	01
Nr. i fideleve	2
Date	23/04/2025
01-030/01-0006347/25	

Komuna e Mitrovicës Veriore
Opština Severna Mitrovica – Municipality of Mitrovica North

Datë: 23/04/2025

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, komuna e Mitrovicës Veriore, në bazë të nenit 42 paragrafi 2 pika 2.3 të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 21 paragrafi 2 pika 2.3 të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, publikon këtë:

SHPALLJE PUBLIKE

Për pranimin e aplikimeve për një (1) Anëtarë të Komisionit të Pranimi (Profesor të fushës së njëjtë për procedurën të cilën zhvillohet konkurrimi) për kategorinë e specialistit

1. Aplikantët për anëtarë të Komisionit të Pranimi (Profesor të fushës së njëjtë për procedurën të cilën zhvillohet konkurrimi) për kategorinë e specialistit, në pajtim me dispozitat e pikës 2.3 paragrafit 2 të nenit 21 të Rregullores (QRK) nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, duhet t'i plotësojnë kriteret si në vijim:

1.1. Profesor në fushën: Inxhinieri e Ndërtimit, Inxhinieri Strukturore, Inxhinieri Arkitekturore, Inxhinieri Gjeoteknike, Hidroteknike.

Aplikantët për anëtarë të Komisionit të Pranimi (profesor të fushës së njëjtë për procedurën të cilën zhvillohet konkurrimi) për kategorinë e specialistit, duhet të dorëzojnë dokumentet si në vijim:

- Biografinë (CV-në);
- Dëshminë e kualifikimit profesional (diplomën e fakultetit). Për diplomat e pranuar jashtë vendit duhet të bashkëngjitet nostrifikimi i diplomës;
- Dëshmitë për përvojën profesionale;
- Deklaratën me shkrim që nuk ka qenë anëtar i organeve drejtuese të ndonjë partie politike të paktën në pesë (5) vitet e fundit;
- Certifikatën e gjendjes penale të lëshuar nga gjykata kompetente jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj;
- Deklaratën me shkrim që nuk është i punësuar në shërbimin civil, që nuk është i larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore dhe që nuk ka masa disiplinore në fuqi;
- Kopjen e letërnjoftimit ose të pasaportës (me afat të vlefshëm me rastin e aplikimit).

I perzgjedhuri për anëtarë të Komisionit të Pranimi (Profesor i fushës së njëjtë për procedurën për të cilën zhvillohet konkurrimi) për kategorinë e specialistit si personalitet i pavarur në Komisionin e Pranimi për kategorinë e specialistit, përfiton një pagesë fikse prej dyqind e pesëdhjetë (250) euro, për procedurë të rekrutimit, në bazë të nenit 21 paragrafi 4 të rregullores (QRK) nr.15/2023 për Procedurat e Pranimi në Shërbimin Civil.

Afati për dorëzimin e CV-se dhe dokumenteve percjellese sipas kësaj thirrje publike për anëtar të Komisionit të Pranimi për kategorinë e Specialistit, është i hapur nga data 24.04.2025 deri me datë 30.04.2025

Për të gjithë të interesuarit ofrohen mundësi të barabarata.

Kandidatët e interesuar për aplikim për një (1) anëtarë të Komisionit të Pranimi (Profesor të fushës së njëjtë për procedurën për të cilën zhvillohet konkurrimi) për kategorinë e Specialistit në fushën e kërkuar, dokumentet e bashkangjitura mund t'i dërgojnë përmes postës elektronike në email adresën: BurimetNjerzore.Mitveri@rks-gov.net